



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr. 2405/6 prot.

Tiranë, më 27.11.2025

REKOMANDIM

Nr. 51, datë 27.11.2025

PËR KONTROLLUESIN “HELIUS SYSTEMS” SH.P.K

Në mbështetje të neneve 81, 82, 83 dhe 84 të ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), si dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit “Helius Systems” shpk (në vijim, “Kontrolluesi”),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 187, datë 23.09.2025 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- *Zbatimi i ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, me fokus masat teknike-organizative për përpunimin e tyre, veçanërisht sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit (SMSI)”.*

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi është shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar me numër identifikimi K91607030D, në Tiranë, i cili ka si objekt aktiviteti: “Krijimin, zhvillimin zbatimin dhe mirëmbajtjen e programeve kompjuterike, teknologji informacioni të prodhuar nga shoqëria ose palë të treta dhe integrimin e sistemeve teknologjike, etj.”

Kontrolluesi në kuadër të veprimtarisë që ushtron, përpunon të dhëna personale për kategoritë “klientë”, “punëmarrës”, etj. Përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike.

2. Kontrolluesi ka krijuar në platformën “Facebook” profile zyrtare, në të cilën pasqyron veprimtari të ndryshme, duke ilustruar nëpërmjet fotografive, të dhënat e subjekteve, “punonjës”, “pjesëmarrës”, etj.

Konstatohet se të dhënat personale të subjekteve janë përpunuar dhe/ose publikuar në rrjetin social “Facebook”, pa marrë paraprakisht pëlqimin e tyre, në kundërshtim me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale dhe me kriteret për përpunimin e tyre, të parashikuara në nenet 6 dhe 7 të Ligjit, si dhe në mungesë të pëlqimit të kërkuar sipas nenit 8 të po këtij Ligji.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, përpunimi i të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, përmes publikimit të fotografive të subjekteve të të dhënave në platforma si “Facebook”, pa marrë paraprakisht “Pëlqimin”, bie në kundërshtim me nenet 6 dhe 7 të Ligjit.

“Pëlqim” është çdo element tregues i vullnetit të subjektit të të dhënave, i dhënë lirisht, i informuar dhe i qartë, nëpërmjet të cilit ai, me anë të një deklarate ose me çdo lloj shfaqjeje tjetër të padyshimtë pohuese të vullnetit, shpreh dakordësinë për përpunimin e të dhënave personale, që lidhen me të për një ose më shumë qëllime specifike.

3. Konstatohet se, Kontrolluesi nuk ka të publikuar “Politikat e Privatësisë” në faqen e internetit <https://helius-software.com>. Subjektet e të dhënave nuk informohen mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t’i përpunojë të dhënat, afatin e mbajtjes së të dhënave, masat e sigurisë, të drejtat që subjektet e të dhënave gëzojnë (për akses, korrigjim dhe fshirje), etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 13 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale pavarësisht faktit nëse përpunimi bëhet në mënyrë elektronike apo manuale, dhe pavarësisht faktit nëse mbledh apo jo të dhëna personale nëpërmjet faqes zyrtare të internetit, ka detyrim që të publikojë rubrikën “Politikat e Privatësisë”, dhe të informojë qartësisht subjektet e të dhënave, pasi kontakti paraprak i çdo subjekti të dhënash me kontrolluesin realizohet nëpërmjet faqes së internetit.

4. Kontrolluesi ka vendosur në dispozicion të grupit të hetimit “Rregullore për mbrojtjen e të dhënave personale”, por nga shqyrtimi i përmbajtjes së saj rezulton se, rregullorja i referohet modelit “tip” të publikuar në faqen zyrtare të Zyrës së Komisionerit.

Konstatohet se, përmbajta e rregullores është e kufizuar dhe nuk reflekton detyrimet ligjore, sipas kategorive specifike të të dhënave personale që përpunon Kontrolluesi, nuk parashikon proceset, procedurat, masat teknike dhe organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 28 të Ligjit, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese të Kontrolluesit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, është i nevojshëm rishikimi i aktit “*Rregullore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*” dhe përshtatja e dispozitave të saj, në mënyrë të tillë që, të parashikohen në mënyrë të detajuar rregulla dhe procedura mbi kategoritë e të dhënave personale që përpunohen, mënyrën e përpunimit, masat e sigurisë dhe konfidencialitetit, afatet e ruajtjes, të drejtat e subjekteve të të dhënave, si dhe përcaktimin e niveleve të aksesit, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese të Kontrolluesit dhe në zbatim të nenit 28 të Ligjit.

5. Kontrolluesi disponon politika lidhur me sigurinë e informacionit, konkretisht:

- Rregullorja për mënyrën e video vëzhgimit në Helius System;
- Regjistri i aktiviteteve të përpunimit.

Konstatohet se, mungojnë elementë të tjerë të sigurisë së të dhënave si “*Analiza e sigurisë së sistemit të arkivimit*” për të gjitha llojet e proceseve përpunuese gjatë ushtrimit të aktivitetit, “*Raport vlerësimi mbi sigurinë në sistemin e arkivimit elektronik dhe fizik*”, “*Kontrolli i sigurisë së sistemit të përpunimit të të dhënave*”, etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 28 të Ligjit, Vendimit nr. 6, datë 05.08.2013 të Komisionerit “*Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale*” (në vijim, “*Vendimi nr. 6*”) dhe Udhëzimit nr. 47, datë 14.09.2018 të Komisionerit “*Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha*” (në vijim, “*Udhëzimi nr. 47*”).

Kontrolluesi gjatë hetimit administrativ, ka vendosur në dispozicion të grupit të kontrollit, kopje të Certifikatës së Konformitetit “*Për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit*” ISO 27001:2023. Megjithatë, rezulton se, Kontrolluesi nuk dokumenton masat organizative dhe teknike të ndërmarra në kuadër të sigurisë së informacionit, gjatë ushtrimit të aktivitetit, veçanërisht nëpërmjet sistemeve elektronike sipas këtij standarti.

Gjithashtu, Kontrolluesi nuk ka ndërmarrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, lidhur me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, në kundërshtim me nenin 34 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 47 të Komisionerit.

Për sa më sipër, grupi i kontrollit konstaton, mosplotësim të detyrimeve në lidhje me ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI), për sa i takon mbrojtjes së të dhënave personale, të parashikuar në Udhëzimin nr. 47, si dhe në zbatim të nenit 28 të Ligjit, për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veçantë të veprimtarisë që Kontrolluesi ushtron.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron, e cila kërkon masa të shtuara

teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale, Kontrolluesi, është i detyruar të krijojë, mirëmbajë dhe administrojë SMSI në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr. 47.

SMSI për mbrojtjen e të dhënave personale duhet të bazohet në standardin ISO 27001:2022, siç parashikohet në nenin 5 të Udhëzimit nr. 48, datë 14.09.2018, të Komisionerit “Për certifikimin e sistemeve të sigurisë së informacionit, të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre” (në vijim, “Udhëzimit nr. 48”) i cili është një sistem i certifikueshëm, për qëllime përputhshmërie me standardin e sipërpërmendur, vetëm me organizma të akredituar dhe autorizuar sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 48.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, bazuar në Kreun IV, të Udhëzimit nr. 47 dhe nenin 34 të Ligjit, Kontrolluesi duhet të marrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, bazuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Trajnimet në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale, duhet të jenë të vazhdueshme dhe të përshtatura sipas nevojave dhe proceseve të punës së Kontrolluesit dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, me qëllim ndërgjegjësimin e punonjësve, të cilët për shkak të proceseve të punës, janë të ngarkuar për përpunimin e të dhënave personale.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është dërguar Kontrolluesit në rrugë postare.

Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesi i Kontrolluesit, është paraqitur në seancën dëgjimore, të datës 04.11.2025, gjatë të cilës ka deklaruar angazhimin për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara gjatë hetimit administrativ. Gjithashtu, përfaqësuesi i Kontrolluesit, para seancës dëgjimore ka depozituar nëpërmjet shkresës administruar me tonën nr. 2405/5 prot., datë 03.11.2025, pretendimet me shkrim lidhur me gjetjet e Procesverbalit të Hetimit Administrativ nr. 2405/2 prot., datë 24.10.2025, konkretisht si më poshtë vijon:

- Lidhur me konstatimin për pikën nr. 2 të Procesverbalit të Hetimit Administrativ nr. 2405/2 prot., datë 24.10.2025, Kontrolluesi pretendon se: “*Publikimet e kryera në platformën "Facebook" bazohen në interesat legjitime të kompanisë për komunikim publik dhe nuk përbëjnë shkelje materiale*”.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, pretendimi i Kontrolluesit nuk qëndron. Përdorimi i rrjetit social “Facebook” për përpunimin e të dhënave personale duhet të zbatohet parimet e përpunimit të drejtë dhe proporcional, duke qenë në përputhje me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale dhe me kriteret për përpunimin e tyre, të parashikuara në nenet 6 dhe 7 të Ligjit, si dhe vetëm në rastet kur është marrë pëlqimi i subjektit të të dhënave sipas kërkesave të nenit 8 të po këtij Ligji.

- Lidhur me konstatimin për pikën nr. 3 të Procesverbalit të Hetimit Administrativ nr. 2405/2 prot., datë 24.10.2025, Kontrolluesi pretendon se: *“Faqja zyrtare e internetit të kompanisë <https://helius-software.com> nuk mbledh asnjë formë të dhënash personale dhe nuk ka proces aktiv përpunimi që të kërkojë njoftim në faqen publike. Megjithatë, faqja është në proces rindërtimi dhe rubrika “Politikat e Privatësisë” do të publikohet në versionin e ri të faqes, e cila është në zhvillim”.*

Zyra e Komisionerit vlerëson se, pretendimi i Kontrolluesit nuk qëndron. Gjithashtu, Zyra e Komisionerit vlerëson se, çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale pavarësisht faktit nëse përpunimi bëhet në mënyrë elektronike apo manuale, dhe pavarësisht faktit nëse mbledh apo jo të dhëna personale nëpërmjet faqes zyrtare të internetit, ka detyrim që të publikojë rubrikën *“Politikat e Privatësisë”*, si dhe të informojë qartësisht subjektet e të dhënave, pasi kontakti paraprak i çdo subjekti të dhënash me kontrolluesin realizohet nëpërmjet faqes së internetit.

- Lidhur me konstatimin e pikës 4 të Procesverbalit të Hetimit Administrativ nr. 2405/2 prot., datë 24.10.2025, Kontrolluesi pretendon se, rregullorja e posaçme *“Rregullore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* nuk është model tip, por dokument i zhvilluar në mënyrë të pavarur, pasi përfshin, ndër të tjera:

- *“Shtojcën nr. 1 me përgjegjësitë sipas departamenteve”;*
- *“Shtojcën nr. 2 me “Deklaratën e Kofidencialitetit”, e cila nënshkruhet për çdo punonjës”;*
- *“Shtojcën nr. 3 “Masat teknike dhe organizative”.*

Zyra e Komisionerit, vlerëson se, është i nevojshëm rishikimi i aktit *“Rregullore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* dhe përshtatja e dispozitave të saj, në mënyrë të tillë që, në të të parashikohen në mënyrë të detajuar, kategoritë e të dhënave personale që përpunohen, rregulla dhe procedura mbi kategoritë e të dhënave personale që përpunohen, mënyrën e përpunimit, masat e sigurisë dhe kofidencialitetit, afatet e ruajtjes, të drejtat e subjekteve të të dhënave, si dhe përcaktimin e niveleve të aksesit, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese të Kontrolluesit dhe në zbatim të nenit 28 të Ligjit.

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e kontrollit gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, si dhe angazhimin e tij për të rikuperuar shkeljet e konstatuara. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe shmang mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 6, 7, 8, 13, 28, 34, 81, 82, 83 dhe 84 të Ligjit,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi, të ketë në vëmendje marrjen e “Pëlqimit” të subjekteve të të dhënave në përputhje me parimet dhe kriteret ligjore të sanksionuara në nenet 6 dhe 7 të Ligjit;
 2. Kontrolluesi, të marrë masa për të publikuar rubrikën “Politikat e Privatësisë” në gjuhën shqip, në faqen e internetit <https://helius-software.com>, me qëllim informimin e plotë të subjekteve të të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 13 të Ligjit;
 3. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 28 të Ligjit, të marrë masa për rishikimin e “Rregullores për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, duke parashikuar në të, masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, për çdo kategori të dhënash dhe për çdo proces përpunimi, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, përcaktimin e niveleve të aksesit etj.;
 4. Kontrolluesi, të marrë masa lidhur me trajnimin e punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, në përputhje me proceset përpunuese që ata kryejnë gjatë veprimtarisë së tyre, sipas parashikimeve të përcaktuara në gjerat “c” dhe “ç”, të pikës 1 të nenit 34 të Ligjit;
 5. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale duhet të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47, lidhur me trajnimin e punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale si dhe për krijimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) për mbrojtjen e të dhënave personale;¹
 6. Kontrolluesi, për shkak të natyrës së veçantë të aktivitetit që ushtron, duhet të marrë masat e nevojshme për të vlerësuar mbi certifikimin e sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit, të të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre, sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 48;²
 7. Në zbatim të nenit 84 të Ligjit, të përmbushen detyrimet, sipas këtij akti brenda afateve, si vijon:
 - (i) vazhdimisht, detyrimin e përcaktuar në pikën 1 më sipër;
 - (ii) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimin e përcaktuar në pikën 2 më sipër;
 - (iii) brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimin e përcaktuar në pikën 3 më sipër;
 - (iv) brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikat 4 dhe 5 më sipër.
- Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti;
8. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra;
 9. Komisioneri, bazuar në gjerën “a”, pika 2, e nenit 83 të Ligjit, paralajmëron kontrolluesit ose përpunuesit se veprimet e përpunimit mund të rezultojnë në

mosplotësim të dispozitave ligjore dhe u jep atyre rekomandime lidhur me përputhshmërinë me ligjin. Në rast të mos zbatimit të tyre, Komisioneri vepron sipas neneve 92, 93 dhe 94 të Ligjit, për vendosjen e sanksioneve administrative në përputhje me nenet përkatëse, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative, në mënyrë të tillë që këto masa të jenë efektive, proporcionale dhe me karakter parandalues.

Ky Rekomandim u shpall sot, më 27.11.2025.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

¹ Udhëzimi nr. 47 dhe Udhëzimi nr. 48 janë shfuqizuar me Udhëzimin nr. 08, datë 20.11.2025 “*Për kriteret shtesë për akreditimin e organizmave certifikues*”.

² Detyrimet e parashikura në Udhëzimin nr. 47 dhe nenin 5 të udhëzimit nr.48, vijnë sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr. 9, datë 20.11.2025 “*Për kriteret e përgjithshme për certifikimin dhe për dhënien e vulave dhe të shenjave të mbrojtjes së të dhënave personale*”.